



Prishtinë, 03 prill 2015  
Kodi i ZRRE: V\_721\_2015

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafin 1.6, Nenit 14, paragrafi 2, nën paragrafin 2.6 dhe 2.16, Nenit 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Rregullën për vendosjen e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe të Tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT);
- Vendimin nr. V\_717\_2015 për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) për OST/OT;
- Metodologjia e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS);
- Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit;
- Metodologjia e Ngarkesave të Operatorit të Tregut; dhe
- Kërkesën e datës 31 mars 2015 të KOSTT SH.A, drejtuar ZRRE-së, për miratimin e ngarkesave të OST/OT.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur më 03 prill 2015 nxori këtë:

## VENDIM

- I. **APROVOHEN** tarifrat dhe ngarkesat, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) Sh.A për vitin relevant tarifor apo SHTE9 që do të hyjnë në fuqi nga 1 prill 2015.

## ARSYETIM

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar nga KOSTT-i, më datë 31 mars 2015 aplikacionin për tarifa dhe ngarkesa të OST/OT;



- Për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e nxjerra dhe të publikuara në ueb faqen e saj si dhe takimet sqaruese që ka mbajtur me të licencuarit gjatë periudhës së shqyrtimit tarifor. Këto dokumente janë:
  - Raport Konsultativ - Kalkulimi i Kostos së Shitjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 09 Mars 2015;
  - Raport Konsultativ - Kalkulimi i MAR-it të KOSTT-it , i publikuar më datën 09 Mars 2015; dhe
  - Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i nëntë i tarifave të energjisë elektrike SHTE9, i publikuar me datën 03 prill 2015;
- II. Duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi dhe pas shqyrtimit të të gjitha shënimeve dhe dokumenteve përkatëse, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Struktura e ngarkesave për KOSTT SH.A, që do të zbatohet nga data 1 prill 2015, përkatësisht në vitin relevant tarifor SHTE9 është dhënë në tabelën e mëposhtme.


GRUPI TARIFOR	ELEMENTI TARIFOR	NJËSIA	TARIFA
Prodhimi i Kyçur në Transmision	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.871
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.031
Prodhimi i Kyçur në Distribucion	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.255
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.031
Furnizimi	Tarifa TNUOS 400/220 kV	€/kW	6.962
	Tarifa TNUOS 110 kV	€/kW	13.584
	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.804
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.029


- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.




**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimin të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE:**

  
Enver Halimi, Kryesues

  
Merita Kostari, Anëtar

  
Krenar Bujupi, Anëtar